



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2019-02

Vendosi: Paneli i përbërë nga një gjykatës i vetëm
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Parashtruar nga: Dr. Fidelma Donlon

Data: 28 shkurt 2019

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Parashtrim i Administratores në bazë të urdhrit të gjykatësit të vetëm të 27
shkurtit 2019 me 19 shtojca konfidenciale**

Parashtruesi

Z. Ruzhdi Saramati

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 18 shkurt 2019, Administratorja nxori një vendim në lidhje me ndihmën juridike ("Vendim në lidhje me ndihmën juridike"),¹ për refuzimin e kërkesës për ndihmë juridike të dorëzuar nga Parashtruesi ("Kërkesa për ndihmë juridike").
2. Më 23 shkurt 2019, Parashtruesi dorëzoi një kërkesë për rishikim ("Kërkesë për rishikim"), e cila u mor nga Kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës më 25 shkurt 2019.
3. Më 26 shkurt 2019, Kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës caktoi një gjykatës të vetëm për rishikimin e vendimit në lidhje me ndihmën juridike.
4. Më 27 shkurt 2019, gjykatësi i vetëm lëshoi një urdhër ("Urdhri")² që deri ditën e premte, 1 mars 2019, Administratorja të dërgonte dokumentet e mëposhtme:
 - a. Kërkesën për ndihmë juridike të dorëzuar nga Parashtruesi, përfshirë të gjitha dokumentet shoqëruese dhe përkthimet e tyre në anglishte;
 - b. çfarëdo Formulari për Deklarimin e Mjeteve Financiare të dorëzuar nga Parashtruesi, përfshirë të gjitha dokumentet shoqëruese dhe përkthimet e tyre në anglishte;
 - c. çdo vlerësim të mëtejshëm të kryer nga Administratorja lidhur me varfërinë e Parashtruesit;
 - d. çfarëdo rregulloreje të brendshme dhe shtojcat përkatëse, nëse ka, mbi bazën e të cilave është bërë vlerësimi i varfërisë dhe është marrë vendimi në lidhje me ndihmën juridike dhe
 - e. çfarëdo dokumenti tjetër që ka lidhje me vlerësimin e kërkesës për rishikim.

¹ Vendim në lidhje me ndihmën juridike, Ref: KSC/REG/IOR/1632, 18 shkurt 2019.

² KSC-BC-2019-02/F00003, Paneli i përbërë nga një gjykatës i vetëm, *Urdhër Administratores për dërgimin e dokumenteve lidhur me vendimin KSC/REG/IOR/1632*, 27 shkurt 2019, publik, para. 11.

II. PARASHTRIM

5. Në përputhje me paragrafin 11 të Urdhrit, Administratorja në vijim dërgon dokumentet - 19 shtojca të veçanta konfidenciale - që ia bashkëngjit këtij parashtrimi. Shtojcat përmbajnë disa mesazhe elektronike (emaille) të brendshme. Emrat dhe adresat e postës elektronike të dërguesve dhe marrësve të këtyre mesazheve elektronike brenda Zyrës Administrative dhe të komunikimeve të brendshme janë hequr. Këto redakte nuk cenojnë përmbajtjen e dokumenteve.
6. Parashtrimet e Administratores në përgjigje të kërkesës për rishikim, në përputhje me paragrafin 12 të Urdhrit, do të dorëzohen më vonë.

Dr. Fidelma Donlon

Administratore

E enjte, 28 shkurt 2019

Në Hagë, Holandë